



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Në bazë të Nenit 3 pika 7 dhe të Nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (LSHCRK), përkatësisht të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: Jurist/e (një pozitë) - Vendi i punës është i rezervuar për qytetarë nga komunitetet Rom, Ashkali, Egjiptas (RAE)

Referenca: IAPK – 3/2014

Paga-koeficienti: 14.84

Mbikqyrësi: Drejtori i Departamentit të Hetimeve

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar, periudha provuese 12 muaj

Vendi: Prishtinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon kërkime ligjore në lëmin e të drejtave të njeriut, zgjedh materialet relevante, i analizon informatat dhe gjetjet për shqyrtim dhe rekomandim të rasteve,
- Asiston dhe këshillon palët mbi çështjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut,
- Kryen hetime për ankesat, kontrollon dosjet dhe dokumentet e administratës publike dhe të institucioneve tjera relevante,
- Monitoron institucionet ku qytetarët janë të privuar nga liria dhe prezanton gjatë takimeve apo seancave dëgjimore që kanë të bëjnë me persona të tillë,
- Mban korrespondencën rreth ankesave të parashtruara nga ankuesit dhe autoritetet tjera relevante,
- Përpilon vendime mbi pranimin e ankesave, fillon hetime për rastet ku pohohet se janë shkelur të drejtat e njeriut apo ndonjë keqpërdorim i autoritetit ndaj individëve, grupeve të individëve apo entiteteve të ndryshme,
- Harton raporte që përmbajnë rekomandime për autoritetet relevante për masat që duhet ndërmarrë,
- Pranon, interviston, këshillon apo udhëzon palët në zyre dhe në terren,
- Ndërmjetëson me autoritetet publike apo organizatat dhe institucionet tjera,
- Kryen detyra të tjera që ndërlidhen me natyrën e punës, të cilat caktohen nga mbikqyrësi.

Përgatitja profesionale, kualifikimi, aftësitë dhe karakteristikat tjera:

- Diplomë universitare në juridik (katërvjeçar) – e obligueshme, kurse kryerja e studimeve Master ose kualifikimet më të avancuara në lëmin e drejtësisë – e preferueshme;
- Së paku 2 (dy) vjet përvojë pune - e obligueshme, preferohet përvoja e punës në fushën e të drejtave të njeriut, në lëmin e drejtësisë ose në institucionet e administratës publike;
- Njohje e gjuhës shqipe ose serbe në të folur dhe të shkruar - e obligueshme;
- Njohja e mirë e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar - preferohet;
- Karakter i lartë moral, paanshmëri dhe integritet për të mbrojtur të drejtat e njeriut;
- Aftësi shumë të mira komunikuese;
- Aftësi të punoj i pavarur, nën presion, i motivuar dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike, me qëndrime dhe opinione të ndryshme;
- Aftësi në përdorimin e kompjuterit në programet e MS Office dhe internet – e obligueshme;
- Vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale (jo më i vjetër se 6 muaj) – i obligueshëm.

Procedura e konkurimit

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

Formularët për punësim mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen e internetit: www.ombudspersonkosovo.org.

Formularët për punësim mund të dorëzohen personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Enver Maloku“, nr. 28, Bregu i diellit, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale (letërnjoftimi dhe ekstrakti i lindjes) dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale.

Në rast të numrit të madh të aplikacioneve, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 23.10.2014.

Kërkesat e dërguara pas kalimit të afatit për aplikim, dhe ato të pakomletuara nuk do të shqyrtohen.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në nurmin e telefonit 038 223 782 apo në email adresën zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar por, nuk janë zgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimit, gjeçjesisht 90 ditë nga momemti i skadimit të afatit të aplikimit. Dokumentet që nuk tërhiqen asgjësohen.